

Njoftim për përqendrimin që i referohet krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët me funksione të plota nga Daimler Trak AG, Gjermani dhe Aktiebolaget Volvo, Suedi

(lënda nr. 08-153 / 2024)

Në përputhje me 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24), më 19.11.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim që i referohet themelimit të një shoqërie që është një ndërmarrje e përbashkët e kontrolluar dhe me funksione të plota, në të cilën Daimler Trak me seli të regjistruar në Fasanenveg 10, 70771 Lajnfelden-Ehterdingen, Gjermani dhe Aktiebolaget Volvo me seli kryesore në Gropegardsgatan 2, 405 08 Getenborg, Suedi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, do të ketë një numër të barabartë aksionesh. Për këtë qëllim, Daimler Trak dhe Aktiebolaget Volvo nënshkruan një Marrëveshje Investimi më 25 tetor 2024.

- **Ndërmarrja e përbashkët** do të themelohet në formën ligjore të një shoqërie aksionare sipas ligjeve të Suedisë (në suedisht: *Aktiebolag*). Mund të ketë një shoqëri të varur në pronësi të plotë dhe në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Gjermanisë (gjermanisht: *Gesellschaft mit beschränkten Haftung*) dhe shoqërive potencialisht të varura shtesë, duke përfshirë një në Indi, e cila do të fokusohet kryesisht në nevojat dhe hulumtimin dhe zhvillimin. Ndërmarrja e përbashkët fillimisht do të themelohet si një shoqëri e varur në pronësi të plotë të Volvo Group. Në datën e mbylljes së Transaksionit, Daimler Trak do të blejë 50% të aksioneve në ndërmarrjen e përbashkët.

Ndërmarrja e përbashkët do të jetë nën kontroll të përbashkët, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga Parashtruesit, do të jetë një person juridik më vete me identitetin e vet korporativ dhe do të ketë burime të mjaftueshme financiare për të punuar në mënyrë të pavarur në baza të përhershme.

Daimler Trak (Daimler Truck) me seli në Lajnfelden-Ehterdingen, Gjermani është 100% një shoqëri e e varur e Daimler Trak Holding AG (Daimler Truck Holding AG), e cila është e listuar në bursën e Frankfurtit. Daimler Trak është një shoqëri operacionale që drejton aktivitetet e Daimler Trak Group në lidhje me prodhimin e kamionëve dhe autobusëve, duke përfshirë markat si Mercedes-Benz Traks, Freightliner, Mitsubishi Fuso, Western Star, Setra dhe Rizon.

Aktiebolaget Volvo është një shoqëri ndërkombëtare me seli në Geteborg, Suedi dhe është e listuar në bursën Nasdaq OMX Nordic. Nëpërmjet aksioneve të saj në shoqëritë e Volvo Group ("Volvo Group"), Volvo është aktive në mbarë botën në prodhimin dhe shitjen e kamionëve komerciale dhe jo-komerciale, autobusëve, pajisjeve të ndërtimit dhe transportit detar, automjeteve komerciale dhe jo-komerciale dhe motorëve industrialë. Portofoli i markave të Grupit Volvo përbëhet nga Volvo, Volvo Penta, Rokbak, Renault Trucks, Prevost, Nova Bus dhe Mack.

Ndërmarrja e përbashkët do të fokusohet në hulumtimin, zhvillimin dhe komercializimin e Platformave SDV për automjete komerciale. SDV (Automjet i Përcaktuar nga Softueri) është një tendencë në zhvillimin e automjeteve, ku përvoja e përdoruesve varet gjithnjë e më shumë nga softueri, jo, si në të kaluarën, kryesisht nga hardueri i automjetit. Automjetet e përcaktuara nga softueri mundësojnë forma të reja të lidhjes, automatizimit dhe veçori të personalizuar.

Tregjet relevante të mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohen si:

—tregu për zhvillimin dhe shitjen e platformave të përcaktuara nga softueri për automjete (Platformat SDV); dhe

—tregu për zhvillimin dhe shitjen e paketave softuerike (stack softuerësh) për dukshmërinë dhe perceptimin e sistemeve të avancuara të ndihmës së shoferit (ADAS)

Pas një shqyrtimi paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

20.11. 2024

Shkup